



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 05.11.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.11.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Eing Com" për aktivitetin: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-2602-511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Eing Com" e datës 02.11.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me Nr.616 18 2602 511 Nr. Brendshëm 616 18 026 511 kundër *Vendimit për dhënje të kontratës* të AK –së, të datës 29.10.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. *Autoriteti Kontraktues vazhdon aktivitetin e prokurimit sipas vendimit për dhënje të kontratës.*
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas vendimit të datës 29.10.2018.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Eing Com" me datë 02.11.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me numër të prokurimit 616 18 2602 511 dhe numër të brendshëm 616 18 026 511. Autoriteti Kontraktues, me datë 05.11.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet për tenderuesin "Eing Com":

1. Per pretendimin numer nje i sqarojme parashtruesit te kerkeses se komisioni i rivleresimit ka dal dhe ka vizituar seline e OE-ik . Komisioni ka konstatuar se ky tenderues i posedon te gjitha paisjet e kerkuara ne dosjen e tenderit.
2. Per pretendimin e dyte ju sqarojme se certifikata fitosanitare per fidanet shkruan ne menyre te qarte se eshte certifikate e brendshme qe do te thote se fidanet jane me origjine vendore .
3. Lidhur me pretendimin numer tre ju sqarojme se ajo kerkese ka te beje me deshmite per realizim te projektit e nuk eshte kusht i FDT-se.
4. Per pretendimin numer kater ju sqarojme se tenderuesi ka sjell marreveshje dhe kalkulimin e cmimit nga furnizuesi qe eshte paraqitur edhe nga tenderuesit e tjetre("Kalaja Epox") , i cili ne te gjitha rastet ka deklaruar garancion 5 vjecar.
5. Lidhur me pretendimet per vonesen e dergimit te sqarimeve nga OE-ik "Rexha " ju sqarojme se ajo ka ndodh si shkak i gabimeve teknike te Departamentit te Prokurimit dhe kur eshte verejtur ky gabim i eshte derguar kerkesa ne adresen e sakte .Ne kerkesat e derguara ne adresen e duhur ,OE-ik eshte pergjigjur brenda afatit te caktuar kohor.

Bazuar ne konstatimet paraprake u vendos si ne dispozitiv .

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit